



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.22/2011
Prishtinë, më 22.07.2011, ora 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri dhe Biserka Kostić.

Munguan: Teuta Sahatqija, Ramiz Kelmendi dhe Myzejene Selmani.

Pjesëmarrës të tjerë: Natyra Kasumi – KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 19.07.2011;
3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime të Projektligjit nr.04/L-026 për markat tregtare;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime të Projektligjit nr.04/L-028 për dizajnin industrial;
5. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime të Projektligjit nr.04/L-029 për patenta;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 19.07.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 19.07.2011 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime te Projektligjit nr.04/L-026 për markat tregtare

Kryetari – Theksoj se Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr.04/L-026 për markat tregtare, pas kthimit pa ndonjë vërejtje nga Komisionet e përhershme duhet të miratohet dhe të procedohet në mbledhje plenare për lexim të dytë.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-026 për markat tregtare.

4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime te Projektligjit nr.04/L-028 për dizajnin industrial

Kryetari – Theksoj se Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr.04/L-028 për dizajnin industrial, pas kthimit pa ndonjë vërejtje nga Komisionet e përhershme duhet të miratohet dhe të procedohet në mbledhje plenare për lexim të dytë.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-028 për dizajnin industrial.

5. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime te Projektligjit nr.04/L-029 për patenta

Kryetari – Theksoje se edhe Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr.04/L-029 për patenta, pas kthimit pa ndonjë vërejtje nga Komisionet e përhershme duhet të miratohet dhe të procedohet në mbledhje plenare për lexim të dytë.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-029 për patenta.

6. Të ndryshme;

a) Mbikëqyrja e zbatimit te ligjit për minierat dhe mineralet.

Sala Berisha- Shala - si kryesuese e grupit punesës për mbikëqyrjen e zbatimit te Ligjit për minierat dhe mineralet, i ftojë të gjithë deputetet e Komisionit që të marrin pjesë në vizita që janë të parapara ne Komunën e Fushë Kosovës, KEK dhe në një Gurthyese ne Bardh të Madh, për hënën më datë 25.07.2011 ne ora 9:00.

b) Njoftimi për vizite ne Bruksel

Kryetari – i njoftoi deputetët e për seminarin: “Transporti dhe infrastruktura ne kontekstin rajonal” të delegacionit të Komisionit Zhvillim ekonomik, infrastrukture, tregti dhe industri dhe për stafin civil të Komisionit, më 12 - 13 korrik 2011, në Bruksel/Belgjikë. Ai potencoi se ne fjalimin e mbajtur ne seminar ka propozuar qe një takim i tille ose konference për këtë çështje te mbahet ne Kosove ne ditët e ardhme. Njëkohësisht i njoftoi deputetet qe një informacion me shkrim nga kjo vizite do ju procedohet Kryesisë dhe tere deputetëve.

c) Mbledhja e radhës

Kryetari – i njoftoi deputetet se gjatë tërë javës së ardhshme do të mblidhet Grupi Punues për t’i shqyrtuar Projektligjet e pakos se AKP-se, dhe do te jete një mbledhje e rregullt e Komisionit për shqyrtim dhe miratim te Raportit me propozim-amendamente.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit